NIJZ Nacionalni inštitut za javno zdravje
TRUBARJEVA 2, 1000 LJUBLJANA
TEL.: 01/244 14 00, TELEFAKS: 01/244 14 47

Svit

PROGRAMI SHTETËROR PËR
EKZAMINIMIN DHE ZBULIMIN
E HERSHËM TE NDRYSHIMEVE
PARAKANCEROZE DHE TË KANCERIT
N ZORRËN E TRASHË DHE REKTUM

**Qendra për Zbulimin e Hershëm të Kancerit**
**Numri i telefonit: 01/620 45 21**
**Laboratori Svit**
**Tehnološki park 24, 1001 Ljubljana**

**Licenca për veprimtari**
**Ministria e Shëndetësisë:**

## EKZAMINIMI LABORATORIK

## EKZAMINIMI PËRFUNDIMTAR

**Pacienti:**

**Data e lindjes:**

**Data dhe ora e pranimit të mostrave të feçes:**

**Data dhe ora e përfundimit të analizës së mostrave të feçes:**

**Data dhe ora e raportit të analizës:**

**Porositësi:** Programi shtetëror për ekzaminimin dhe zbulimin e hershëm të ndryshimeve parakanceroze dhe kancerit në zorrën e trashë dhe rektum.

**Ekzaminimi i feçes:**

| Ekzaminimi | Rezultati | Vlera e rekomanduar për testin e shqyrtimit (Cut off) | Njësia |
|---|---|---|---|
| F-Hb spec. – mostra I | | 0,0–20,0 | µg/g |
| F-Hb spec. – mostra II | | 0,0–20,0 | µg/g |

**Rezultatet i përpunoi:**

**Personi përgjegjës:**

**Mendim:**
Analiza e ekzaminimit laboratorik për hemorragji të fshehtë në feçe është **pozitive**.

**Drejtuesi i laboratorit:**

*Ju lutemi, ktheni fletën!*

## MENDIM

Në laboratorin tonë kemi ekzaminuar të dyja mostrat e feçes tuaj të pranuar. Ju informojmë se analiza laboratorike për gjakderdhje të fshehtë në feçe është pozitive.

**Testi pozitiv** i ekzaminimit për gjakrrjedhje të fshehtë nënkupton që mostrat e gjakut janë bllokuar në mostrat e feçes suaj. **Kjo nuk do të thotë që ju keni kancer në zorrën e trashë ose rektum. Shumica e njerëzve me një rezultat pozitiv nuk kanë kancer.** Ekzaminimet do të thonë vetëm se ka ndryshime në zorrë që kanë shkaktuar gjakderdhje, kështu që ato duhet të hulumtohen më tej. Për të përcaktuar shkakun e gjakderdhjes, duhet të kryhet shqyrtimi i zorrës së trashë. Kontrolli më i përshtatshëm është një **kolonoskopi.** Mund të lexoni më shumë rreth saj dhe të përgatiteni për të në materialin e bashkangjitur.

Ne gjithashtu informuam mjekun tuaj personal rreth rezultatit. **Ju lutemi që me këtë analizë dhe me të gjitha bashkëlidhjet, të vizitoheni maksimumi brenda një jave.** Mjeku juaj do t'ju kontrollojë dhe të zbulojë nëse ka ndonjë pengesë shëndetësore për kryerjen nga ana juaj të një ekzaminimi më të hollësishëm - kolonoskopisë. Nëse shëndeti juaj jua lejon të kryeni këtë, mjeku juaj:

- do të plotësojë një **rekomandim** për kolonoskopinë e SVIT-it,
- do të plotësojë një **recetë** për preparatin e pastrimit Moviprep® (mund ta merrni falas në farmaci),
- do të plotësoni së bashku **pyetësorin** bashkëngjitur, i cili do t'i dorëzohet mjekut specialist të kolonoskopisë,
- do të japë të gjitha udhëzimet e nevojshme që kanë të bëjnë me barnat që ndikojnë në kolonoskopi nëse i merrni rastësisht (përfshirë këtu barnat për diabetin, holluesit e gjakut etj.),
- do të japë rezultatet e kolonoskopisë së mëparshme ose të konstatimeve të tjera që do të ndikonin në kontroll ose dokumentacionin tjetër mjekësor sipas gjykimit të tij personal.

Ju lutemi që, pasi të kontaktoni mjekun tuaj, të na telefononi menjëherë në numrin e telefonit 01/620 45 22, nga e hëna deri të premten, nga ora 09:00 deri në orën 14:00 për të diskutuar kohën dhe vendin që ju përshtatet më mirë për kryerjen e kolonoskopisë tuaj. Ju gjithashtu mund të dërgoni email në adresën svit@nijz.si ose të na dërgoni një njoftim me telefaks në numrin 01/620 45 29. Nëpërmjet postës, për këtë gjë do t'ju dërgojmë një njoftim me datën dhe orën e saktë të shqyrtimit dhe adresën e klinikës në të cilën do të kryeni kontrollin.

**Ju lutemi gjithashtu të na kontaktoni nëse mjeku juaj përcakton se kolonoskopia nuk mund të kryhet momentalisht për shkak të gjendjes tuaj.**

Duke u kujdesur për shëndetin tuaj ju përshëndesim ngrohtësisht.

*Bashkëpunëtorët e Programit Svit*



**Programi Svit** • Tehnološki park 24 • p.p. 241, SI – 1001 Ljubljana
telefon 01/620 45 21 • telefaks 01/620 45 29 • svit@nijz.si • www.program-svit.si